

**VENDIM**  
**Nr. 752, datë 23.9.2020**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR  
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, MEDRESEJA “HAFIZ ABDULLAH ZËMBLAKU”,  
KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, fetar, të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë, hapur me vendimin nr. 602, datë 4.12.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat, medreseja ‘Hafiz Abdullah Zëmbaku’”.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë, ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor dokumentacionin dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar një kopje të procesverbalit të dorëzimit dhe të dokumentacionit, sipas afateve të parashikuara në legjisllacionin në fuqi;

d) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë.

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor privat.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i cili nuk zbaton këtë vendim.

5. Vendimi nr. 602, datë 4.12.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat, medreseja ‘Hafiz Abdullah Zëmbaku’”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, institucioni arsimor privat medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**